



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.14, ora 9:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.
3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Tom Doshi, Fatmir Mediu dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Katrin Treska – eksperte ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi! Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës kemi fillimisht projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.08.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”” dhe si pikë të dytë projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Për projektligjin e parë relatore është zonja Caka, ndërsa për projektligjin e dytë relator është zoti Subashi.

Nga Ministria e Drejtësisë janë të pranishëm: zoti Arben Isaraj, zëvendësministër, zonja Edlira Jorgaqi, drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit, dhe zonja Katrin Treska, drejtoreshë.

Faleminderit që jeni të pranishëm për të dyja projektligjet!

Meqenëse kjo është një iniciativë deputetësh, fillimisht do të dëgjojmë zonjën Felaj, pastaj zonjën Caka për një paraqitje të shkurtër dhe më pas përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë nëse kanë ndonjë koment, pavarësisht se e kanë dhënë me shkrim.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve, në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe kalendarit të punës së Komisionit të Ligjeve për periudhën 4-25 korrik 2014 janë caktuar relatorët për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Kjo është iniciativë e një grupi deputetësh për të cilin Komisioni i Ligjeve është edhe komision përgjegjës.

Duke kaluar në iniciativën konkrete që një grup deputetësh i këtij komisioni i ka paraqitur Kuvendit, unë do t’ju bëja me dije ~~cili është~~ qëllimin e aktit ose të ndryshimit që ne kërkojmë të bëjmë në Kodin e Procedurës Penale. Kemi parasysh që Komisioni i Ligjeve përpara disa kohësh ka miratuar me unanimitet ndryshime në Kodin Penal dhe për shkak të tyre ndërvaret edhe propozimi ynë.

Ndryshimi i propozuar në Kodin e Procedurës Penale synon kalimin e kompetencës lëndore për hetimin dhe gjykimin e tri veprave penale të shtuara pas nenit 265 të Kodit Penal Gjykatës për Krimet e Rënda dhe përkatësisht nenet 265/a “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj”, neni 265/b “Organizimi për pjesëmarrjen në veprime luftarake në një shtet të huaj”, neni 265/c “Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj”. Propozimi për të ndryshuar nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, i cili bën

fjalë për kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda, argumentohet me faktin se sistemi prokurori-Gjykata e Krimeve të Rënda tashmë është sprovuar në përballimin e hetimeve dhe gjykimeve të çështjeve me vështirësi dhe specifika të veçanta sikurse janë çështjet në fjalë.

Vetë ana objektive e këtyre veprave penale të propozuara për t'u shtuar në Kodin Penal është e tillë që kërkon një koordinim dhe bashkëpunim të plotë me strukturat homologe ndërkombëtare. Pra, hetimi i tyre nuk mund të bëhet nga çdo prokurori ose çdo gjykatë e zakonshme.

Në të tilla kushte, eksperiencia e fituar nga ana e prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet ndërkombëtare të hetimit dhe të gjyimit do të ndikonte në rritjen e efektivitetit, në parandalimin, në goditjen dhe në ndëshkimin e elementëve të përfshirë në këto vepra penale. Po ashtu, kalimi i këtyre veprave në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda do të shmangte edhe vështirësitë që mund të hasen në trajtimin e këtyre veprimeve kriminale nga ana e strukturave vendore të gjykatave, prokurorive dhe kryesisht të Policisë Gjyqësore të vendosura pranë drejtorive dhe komisariateve të policisë, për shkak të njohjes së thatë që mund të kenë për anën objektive dhe për subjektet kriminale që konsumojnë vepra të tilla penale.

Në propozimin e këtij ndryshimi, në dispozitën e nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale është mbajtur parasysh edhe përvoja e deritanishme në trajtimin e fenomenit dhe të veprave penale të ngjashme, të cilat, në fakt, po trajtohen ekskluzivisht nga Prokuroria dhe Gjykata për Krimet e Rënda.

Po ashtu, dua t'ju kujtoj se gjatë diskutimit që kemi pasur në komision për ndryshimet e bëra në Kodin Penal lidhur me tre veprat penale, të cilat u përmendën, si Prokuroria për Krimet e Rënda, ashtu edhe Gjykata për Krimet e Rënda i kanë sugjeruar këtij komisioni edhe ndryshimin përkatës në Kodin e Procedurës Penale. Pra, iniciativa e grupit të deputetëve të Komisionit të Ligjeve është tërësisht e mbështetur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjykata e Krimeve të Rënda.

Në pikëpamjen e Kushtetutës dhe të procedurës, iniciativa jonë është në përputhje me të dyja, kështu që do t'u sugjeroja të gjithë kolegëve që ta miratojmë këtë projektligj duke lejuar kalimin e tij për votim në seancë plenare së bashku me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"". Pra, është e nevojshme që edhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, edhe ndryshimet në Kodin Penal të jenë të njëkohshme, të hyjnë njëkohësisht në fuqi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Fjalën e ka relatorja, zonja Caka.

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, pa dashur t'i shtoj asgjë asaj që tha deputetja Felaj, si një nga nismëtarët, mund të them se pranë Komisionit të Ligjeve kanë sjellë mendim në lidhje me këto ndryshime Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, të cilat janë shprehur plotësisht dakord me ndryshimet e propozuara. E vetmja gjë që dua të theksoj është se komisioni konstaton se miratimi është bazuar në nenin 81, pika 2 të Kushtetutës dhe se ndryshimet kërkojnë një votim me shumicë të cilësuar, pra tre të pestat e anëtarëve.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Caka!

Ka pyetje? Nuk ka.

Ministria është shprehur dakord edhe zyrtarisht me shkresë, por nëse ka ndonjë koment...

Po, zoti Isaraj.

Arben Isaraj – Sigurisht, pa i hyrë nismës, e cila gjen mbështetje gjithandej, kam një merak të cilin dua t'jua shpreh juve, pasi Kuvendi ka një pozicion midis ndarjes së famshme të tri pushteteve që kemi. Shqetësimi vjen faktikisht nga gjyqësori. E shoh edhe në relacion që quhet "Prokuroria e Krimeve të Rënda, Gjykata e Krimeve të Rënda, histori suksesi nga viti 2004..." e të tjera. Unë mendoj se ka ardhur koha që së bashku, por, kuptohet më vonë, t'i hyjmë edhe një herë historisë së organizimit të kësaj gjykate, sepse vetë gjykata ka problematikat e saj në lidhje me çështjet. Gjykata e Krimeve të Rënda nuk gjykon më. Gjyqtarët zëvendësohen me absurditetin e vet, por gjykojnë gjyqtarë të tjerë, të cilët sillen nga sistemi tjetër, dhe në fund gjithçka shkon në Gjykatën e Lartë, ku nuk është ky gjykim, nuk është kjo shpejtësi, nuk është ky nivel gjykimi. Kështu që jashtë asaj që po diskutojmë këtu, është mirë që diku më mbrapa të mblidhemi së bashku, të marrim dhe gjyqësorin për të analizuar që ky sukses që është te prokuroria dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda nuk nxjerr problematikat e veta, por gjykata vetë e ka këtë problematikë nga Gjykata e Krimeve të Rënda e sipër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Isaraj!

Pa i hyrë shprehjes së pozicioneve për atë çfarë ju parashtruat, që unë besoj se do të jetë pjesë e një debati shumë më të gjerë se kaq, është ai lidhur me reformën në drejtësi. Pastaj, opinionet mund të jenë të ndryshme për këtë çështje, por gjithsesi mbetet një çështje për t'u debatuar dhe për t'u vendosur kur t'i vijë radha gjatë hapjes së debatit të gjerë dhe gjithëpërfshirës për reformën në drejtësi.

Meqenëse edhe ministria është dakord, ka diskutime? Nuk ka.

Ermonela Felaj – Ka edhe një propozim tjetër në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”. Janë propozuar të bëhen disa ndërhyrje, konkretisht në nenin 490, i cili bën fjalë për kushtet e ekstradimit, si dhe në nenin 506, i cili bën fjalë për procedimin gjyqësor në rastin e letërporosive nga jashtë shtetit.

Në fund të paragrafit të tretë të nenit 490 kërkohet të shtohen fjalët “pa tejkaluar parashikimet e akteve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë”, ndërsa në nenin 506 kërkohet të bëhet një ndryshim tjetër, ku në fund të paragrafit të dytë të shtohen fjalët “brenda pesë ditëve nga paraqitja e akteve nga Ministria e Drejtësisë”. Një ndryshim në këtë nen kërkohet të bëhet edhe në dy paragrafët e tjerë, në paragrafin e tretë dhe të katërt, ku kërkohet të ndryshohen afatet e paraqitjes së kërkesës, pra në rastin e paragrafit të tretë neni 506 afati të jetë dhjetë ditë, në rastin e germës “a,” të paragrafit të katërt të këtij neni kërkohet që kur është rasti që Ministria e Drejtësisë nuk u jep rrugë letërporosive në përputhje edhe me parashikimet e akteve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Cila është ideja e këtyre ndryshimeve? Ideja e këtyre ndryshimeve është lehtësimi i veprimeve në rastin e marrëdhënieve juridiksionale. Pra, ka ardhur koha që këto marrëdhënie të realizohen, për sa i takon kohës në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më efektive, me qëllim që autoritetet gjyqësore apo autoritetet proceduese në përgjithësi të kenë mundësi të disponojnë mbi provat, mbi dëshmitë në një kohë sa më të shpejtë.

Kuptohet, letërporositë shërbejnë për të bërë komunikimet, njoftimet, për të marrë prova në një shtet të huaj dhe anasjelltas dhe në kohën që hetojmë, kur veprat penale nuk kanë më thjesht shtrirje kombëtare, por përtej asaj kombëtare, pra kalojnë territorin kombëtar, konsumohen në territore jashtë atij kombëtar. Është e nevojshme që ne t'u japim këtë mundësi organeve gjyqësore që ato të veprojnë sa më shpejt.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Në dijeninë time, Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë janë dakord edhe për arsye të disa detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë. Gjithsesi, nëse ka një opinion në këtë moment nga ministria, do ta vlerësonim.

Zoti Isaraj?

Arben Isaraj – Sigurisht, nuk kam pse të zgjatem në atë që thatë, zoti kryetar, është një grup i përbashkët pune i Ministrisë së Drejtësisë me Ministrinë e Financave, sidomos me Drejtorinë e Pastrimit të Parave që ka kohë që ka filluar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Përfshihet edhe kjo në dispozitat që do të miratohen me ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale.

Kush është dakord në parim me iniciativën? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shqyrtimin nen për nen do ta bëjmë në një nga ditët në vijim, për shkak se OPDAT-i ka kërkuar të japë një opinion lidhur me këtë iniciativë, më shumë me amendamentet e reja që u propozuan edhe këtu dhe që janë produkt i një konsultimi të gjerë, por gjithsesi mendojmë se është mirë t'i japim kohën e mjaftueshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.07.14, ora 09:45

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Tahir Muhedini, Tom Doshi, Fatmir Mediu dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Katrin Treska – eksperte ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nismë e Këshillit të Ministrave, e iniciuar nga Ministria e Drejtësisë.

Fillimisht do të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe pastaj relatorin për të vijuar me procedurën e zakonshme.

Zoti Isaraj, ju lutem na bëni një prezantim të shkurtër të nismës.

Arben Isaraj – Të nderuar deputetë,

Një ndër përparësitë e qeverisë shqiptare është edhe reforma në gjyqësor, e cila jo vetëm është ideuar nga programi politik i qeverisë, i miratuar në parlament, por edhe në përgjigje të rekomandimeve të progresraportit të vitit 2013, i cili adreson plotësimin e kuadrit ligjor për reformën gjyqësore, duke theksuar se disa masa janë ende të papërfunduara.

Propozimi i këtij projektligji vjen gjithashtu si nevojë e domosdoshme për të balancuar ngarkesën e punës së gjykatave, me qëllim rritjen e efikasitetit, rritjen e përgjegjshmërisë, e besueshmërisë në dhënien e drejtësisë dhe në shërbimin sa më profesional ndaj qytetarëve.

Projektligji është konceptuar në mënyrë që të lehtësojë punën e gjyqtarëve të gjykatave Administrative, duke u garantuar atyre pavarësinë në ushtrimin e funksionit të tyre dhe duke parashikuar dispozita të reja lidhur me kushte të përcaktuara në ligj rreth kandidaturave për ndihmësligjorë pranë gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ.

Ky projektligj propozohet në mbështetje të neneve 81, 83 dhe 135 të Kushtetutës dhe synon të harmonizojë statusin e ndihmësit ligjor në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor, veçanërisht me këtë rast në gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Apelit Administrativ.

Projektligji ka në përbërjen e tij shtatë nene të shtjelluara, siç vijon në relacionin që ju, të nderuar deputetë, keni përpara dhe të miratuar në Këshillin e Ministrave së bashku me projektligjin që kemi paraqitur.

Risia që unë dua të them në gjithë këtë proces është gjëja e parë që ne e përfituam nga ligji i mëparshëm. Në ligjin e mëparshëm, flitej për ndihmësin ligjor vetëm në nenin 6, ku shpjegohej se çfarë ishte ndihmësi ligjor, por nuk flitej absolutisht sesi përzgjidhej dhe si do të shërbente pranë këtyre gjykatave.

Sigurisht, risia që sjell ky proces është pikërisht në këtë, për ta bërë sa më të mundshme që ndihmësit ligjorë, ashtu si asnjëherë tjetër, të jenë pikërisht njerëz që të

ndihmojnë gjyqtarin në punën e tij të përditshme dhe jo të bëjnë atë punë që mund të mendohej përpara, siç janë sekretarët, kancelarët e të tjerë.

Meraku i vetëm kur shtohen detyra ose funksione në këtë është i pjesës financiare. Besoj se për 28 deri në 30 veta, sa është programuar, janë të parashikuara në buxhetin e shtetit.

Ne jemi të hapur për çdo debat tjetër, pa i hyrë asaj, dhe unë do të dëgjoj me kënaqësi edhe relatorin, edhe opinionet që mund të kenë pasur pjesëtarët në proces ose shoqata që monitorojnë procesin.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Isaraj!

Fjalën e ka zoti Subashi.

Armando Subashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, propozimi që ka ardhur sot, ashtu sikurse e tha edhe zoti Isaraj, i ka fillesat e veta disa vite më parë. Unë do ta quaja problemin e ndihmësve ligjorë një risi që solli ligji i gjykatave Administrative. Sigurisht, shkëndija e parë në këtë mes u dha me miratimin e ligjit bazë “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, që u parashikua diçka në këtë drejtim, por me vetëdije të plotë një pjesë e kolegëve e mbajnë mend se, kur kemi miratuar ligjin “Për Gjykatën Administrative”, kemi këmbëngulur fort, sidomos pjesa jonë (opozita e asaj kohe), që ky ligj të parashikonte edhe ndihmësit ligjorë, pasi kemi qenë të mendimit se kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e mirëfunksionimit të pushtetit gjyqësor.

Sipas pikëpamjes sonë, ata janë një ndihmë shumë e madhe ndaj gjyqtarëve për të ulur ngarkesën e punës, për të bërë punën e duhur përgatitore qoftë para gjykimit të një çështjeje, por edhe pas gjykimit të saj. Nga kjo pikëpamje mendojmë se prania e tyre në Gjykatën Administrative të Apelit pa dyshim që është shumë e rëndësishme. Sigurisht, ai ligj nuk i detajonte të gjitha këto modalitete që kanë ardhur sot, pra çfarë statusi do të kishin këta, do të anonin më shumë, të themi, drejt gjyqtarëve (pra nga pjesa e gjyqësorit), apo do të anonin më shumë nga pjesa e administratës gjyqësore, si do të përzgjidheshin, nga do të emëroheshin, çfarë kriteresh duhet të përmbushnin e të tjera.

Sigurisht, unë e përgëzoj pa dyshim stafin e Ministrisë së Drejtësisë për këtë draft që ka sjellë në këtë drejtim dhe shumë mirë bëjmë, jemi në kohën e duhur për t’i detajuar të gjitha këto momente dhe pa dyshim t’i hapim rrugë procesit që atje të fillojnë ndihmësit ligjorë, sepse edhe situata e sotme në ato gjykata është shumë e ngarkuar.

Ndoshta kur të vijmë në shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji, pa dyshim rezervoj të drejtën, ashtu si edhe kolegët e tjerë, të bëj ndoshta propozimet e duhura në këtë drejtim. Kemi mbledhur tashmë disa opinione qoftë nga Konferenca Gjyqësore, qoftë nga OSBE-ja, presim edhe disa opinione të tjera në këtë drejtim lidhur me draftin dhe pa dyshim, duke i marrë të gjitha këto, besoj se kur të vijë momenti i shqyrtimit nen për nen do të arrijmë në një konkluzion sa më të drejtë në këtë drejtim.

Për ta mbyllur, meqenëse jemi në këtë moment dhe sigurisht është ndoshta hera e parë pas miratimit të atij ligji që ne bëjmë plotësime në ligjin bazë për gjykatat Administrative, është momenti që ndoshta ne mund të shikonim edhe disa ndryshime të tjera të cilat janë propozuar qoftë nga Konferenca Gjyqësore, qoftë edhe nga një pjesë e anëtarëve të Gjykatës së Lartë që bëjnë pjesë në Kolegjin Administrativ. Bëhet fjalë kryesisht për disa nene të cilat mund të lehtësonin edhe më tej procedurat e gjykimit për t'u dhënë më shumë shpejtësi gjykimeve administrative, sigurisht pa prekur thelbin e tyre dhe cilësinë e këtyre gjykimeve. Kështu që nga kjo pikëpamje shumë mirë që e hapim procesin sot e pa dyshim në ditët në vijim besoj se do të evidentojmë të gjitha këto momente për ta plotësuar sa më mirë këtë ligj, jo vetëm në raport me ndihmësit ligjorë, por edhe me disa institute të tjera, të cilat ndoshta kanë nevojë të përmirësohen dhe të rregullohen, nisur edhe nga praktika disamujore në gjykimin e çështjeve në këto gjykata.

Përfundimisht, unë jam dakord parimisht, pra e mbështes draftin e ministrisë dhe sigurisht në shqyrtimin nen për nen do të shikojmë edhe modalitetet teknike në raport me rregullimin e tyre.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Subashi!

Ka pyetje? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka. Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Me sa kuptova nga relatori, duke parë me kujdes gjithashtu opinionin e sjellë nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore, që është përtej projektit që ka sjellë ministria, ka njëkohësisht një sërë propozimesh të tjera për amendamente në ligjin bazë. Kjo kërkon një kohë që të njihen kolegët, besoj se duhet të njihet edhe vetë ministria dhe relatori, sepse këto opinione kanë ardhur dje.

Kështu që mendoj ta ndërpresim këtu që t'u japim mundësi relatorit, kolegëve deputetë, Ministrisë së Drejtësisë që të njihen më në detaje me propozimet e sjella, në mënyrë që debati që do të zhvillohet në komision nen për nen të jetë sa më produktiv.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nesër në rendin e ditës kemi shqyrtimin në parim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Kështu që prezente do të jetë Ministria e Drejtësisë, meqenëse është nismë e Këshillit të Ministrave, iniciuar nga kjo ministri. Si pikë e dytë do të jetë projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nismë deputetësh, dhe si pikë e tretë do të jetë projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136 “Për Shkollën e Magjistraturës”, gjithashtu nismë e një grupi deputetësh. Të tria projektligjet e nesërme lidhen me fushën e drejtësisë. Ndaj do t'u lutesha deputetëve që të njihen me projektligjet e ardhura dhe me opinionet, vlerësimet që kanë ardhur nga grupet e interesit ose organizata të ndryshme, të cilave u është kërkuar opinioni lidhur me këto tri projektligje.

E mbyllim mbledhjen këtu.

Faleminderit, zoti Isaraj! Faleminderit, zonja Jorgaqi! Faleminderit, zonja Treska!

Faleminderit kolegëve!

Faleminderit edhe medias!

Mbledhja tjetër është nesër në orën 09:30.